



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
KRYESIA

Nr. 278 prot.

Tiranë, më 24.07. 2019

Vendim
nr. 14 datë 24.07. 2019

Për shpalljen e konkursit retrospektiv për veprën shkencore më cilësore për antifashizmin në Shqipëri, botuar në periudhën 1991-2019

Në kuadër të përkujtimit të 75-vjetorit të antifashizmit në Shqipëri

Drejtuar :

- Universiteteve, institucioneve dhe qendrave kërkimore-shkencore, shtëpive botuese, kërkuesve shkencorë të pavaruar.
- Akademisë së të Rinjve;

Për dijeni:

- Asamblesë së Akademisë së Shkencave, drejtuesve të seksioneve shkencore, sektorit të botimeve shkencore dhe bibliotekës, sektorit të financës dhe sektorit të personelit;

Referuar:

- Nenit 4, pika f e ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006 *Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë*, sipas të cilit ky institucion organizon konkurse dhe dhënie çmimesh shkencore;
- Urdhrit nr. 11 datë 6 tetor 2016, *Për miratimin e Rregullores "Për themelimin e çmimeve vjetore shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; për mënyrën e organizimit të konkurseve; për kriteret e zgjedhjes së fituesve dhe mënyrën e shpalljes së tyre"*;
- Urdhrit nr. 89 datë 8.5.2019, *Për ngritjen e komisioneve shtetërore për përkujtimin e 75-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë*, pikat 3 dhe 4;

-Vendimit të komisionit shkencor shtetëror të ngritur pranë Këshillit të Ministrave për përkujtimin dhe festimet në nderim të 75-vjetorit të fitores antifashiste në Shqipëri, pika 10;

-Propozimeve të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike të Akademisë së Shkencave (bashkëngjitur);

Vendosa:

1. Shpalljen e konkursit retrospektiv për veprën shkencore më cilësore nga autorë vendës dhe të huaj kushtuar antifashizmit në Shqipëri (1939-1944).

2. Në konkurs pranohen vepra shkencore të botuara në periudhën 1991-2019.

3. Çmimet që akordohen në përfundim të këtij konkursi janë:

- Për veprën shkencore më cilësore për antifashizmin në Shqipëri, nga autorë vendës;
- Për veprën shkencore më cilësore për antifashizmin në Shqipëri, nga autorë të huaj;
- Për veprën shkencore më cilësore për antifashizmin në Shqipëri, nga studiues të rinj.

4. Pjesëmarrja në konkurs është e hapur dhe shpallja publike e tij bëhet përmes këtij vendimi.

5. Të drejtën e propozimit të veprave për konkurrim e kanë: institucionet akademike-universitare, botuesit dhe autorët vetë.

6. Për organizmin e këtij konkursi pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ngrihet dhe funksionon një juri ndërkombëtare e specializuar, me studiues vendës e të huaj. Kjo juri ngarkohet që, në mënyrë autonome, të bëjë përzgjedhjen, nominimin dhe shpalljen e tre fituesve, sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij vendimi.

7. Pranimi i veprave konkurruese mbyllet më datën 30 shtator 2019 duke depozituar në zyrën e protokollit të Akademisë së Shkencave: *kërkesën për pjesëmarrje në konkurs, 2 kopje të botuara të veprës, deklaratën e origjinalitetit të punimit të paraqitur, CV-në e autorit dhe listën e punimeve*. Nominimi i të përzgjedhurve shpallet nga juria jo më vonë se data 20 tetor 2019. Ceremonia e ndarjes së çmimeve organizohet më 13-16 nëntor, në kuadër të konferencës shkencore akademike *Antifashizmi popullor i shqiptarëve*.

8. Ndarja e diplomave të nderit dhe e shenjës së fituesit të konkursit bëhet me një ceremoni publike. Për secilin nga fituesit Akademia e Shkencave akordon një shpërblim në masën 300.000 lekë.

8. Ngarkohet Këshilli Ekzekutiv i Akademisë së Shkencave që, në bashkëpunim me Seksionin e Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, të organizojë punën për krijimin e kushteve të nevojshme për konkurrim transparent, si dhe për funksionimin e jurisë sipas *Rregullores së çmimeve shkencore kombëtare* në fuqi, cituar në pikën 2 të referencave ligjore të këtij urdhri.

9. Ngarkohet specialisti i komunikimeve shkencore dhe i marrëdhënieve me jashtë e publikun për njoftimin e këtij vendimi.

10. Ngarkohet specialisti IT për publikimin e këtij vendimi.

11. Ngarkohet sekretari shkencor për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Zëvendëskryetar

Akademik Vasil S. TOLE

